

VENDIM
Nr.274, datë 6.4.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS QË
LIDH NDËRTESEN E RE TË QENDRËS DISPEÇER DHE ZYRAT E OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SHA, ME NËNSTACIONIN 400 KV, KASHAR,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës që lidh ndërtesën e re të qendrës dispeçer dhe zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me nënstacionin 400 kV, Kashar, Tiranë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të “OST” sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 8 535 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) m² tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 3 993 276 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 993 276 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e “OST” sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 740 000 (shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të përballohet nga “OST” sh.a., si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit maj 2011 dhe të përfundojë brenda muajit nëntor 2011.

7. Pagesa e të shpronësuarve të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e rrugës që lidh ndërtesën e re të qendrës dispeçer dhe zyrat të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me nënstacionin 400 kV, Kashar, Tiranë, të përfundojnë brenda muajit nëntor 2011.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe “OST” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha